

KU MUNGON FLIJIMI EDHE KËRKESAVE U MUNGON FUQIA MORALE Bisedë mes Robert Elsie-t dhe Rexhep Qosjes

Mospajtimet me politikën e LDK-së

[Robert Elsie]: Profesor Qosja, prej kohësh jeni i njohur si shkencëtar, shkrimtar dhe historian letrar, por kohët e fundit duket se jeni bërë i njohur si “baba i kombit shqiptar”. Si ju duket të keni gjashtë apo shtatë milion fëmijë?

[Rexhep Qosja]: Më quajnë ashtu për shkak të konceptit tim mbi shtruarjen dhe zgjidhjen tërësore të çështjes shqiptare. Po, nuk ka dyshim se dikush më nderon e dikush më qorton me togfjalëshin “baba i kombit shqiptar”, kurse unë nuk e dua atë togfjalësh. Ja, se pse. Kombi shqiptar, si njëri prej popujve më të lashtë të Ballkanit, është historikisht mjaft i pjekur që të mos ketë nevojë për kurrfarë babai. Populli shqiptar ka nevojë, ndërkaq, të çlirohet - pjesa e tij ende e paçliruar, kurse të ketë institucione demokratike, të ketë shtet juridik, me një fjalë të ketë qeverisje demokratike - pjesa e tij që jeton në shtetin e vet.

[Robert Elsie]: Si shumë bashkatdhetarë tuaj, ju përpiqeni të gjeni zgjidhje të duhur për çështjen shqiptare, dmth. për problemin e Kosovës. Me sa di unë, jeni përkrahës i një politike më radikale në krahasim me LDK-në. Cili është ndryshimi midis qindrimin tuaj dhe qindrimin të LDK-së?

[Rexhep Qosja]: Çështja kombëtare shqiptare nuk mund të rrëgjohet në çështjen e Kosovës, sado që Kosova është përbërësi më i rëndësishëm i çështjes shqiptare. Çështje shqiptare unë quaj çështjen e të gjithë shqiptarëve të paçliruar në trojet shqiptare që kufizojnë me Shqipërinë, domethënë në tokat që kanë vazhdimësi gjeografike-etnike me Shqipërinë dhe në të cilat shqiptarët janë popullatë e vetme apo shumicë e madhe. E këtë hapësirë e përbëjnë jo vetëm Kosova, por edhe Maqedonia Perëndimore dhe trevat shqiptare të banuara me shqiptarë në Mal të Zi. Zgjidhje tërësore e çështjes shqiptare mund të quhet vetëm zgjidhja e çështjes së të gjithë këtyre shqiptarëve. Çështje shqiptare unë quaj edhe çështjen e ndërtimit të demokracisë dhe të zhvillimit lëndor e kulturor të kombit shqiptar në përgjithësi. Domethënë - çështja shqiptare për mua shtrohet sot si çështje kombëtare dhe si çështje zhvillimore e Kombit shqiptar.

Ndryshimet midis pikëpamjeve të mia dhe të politikës së LDK-së për zgjidhjen e çështjes shqiptare, pa dyshim, janë të mëdha. LDK-ja është parti politike e cila kur flet për çështjen shqiptare mendon vetëm për çështjen e Kosovës, kurse unë tregova se çka mendoj se quhet çështje shqiptare.

LDK-ja është parti politike që bën politikë partiake, domethënë parti që lufton për pushtet, prandaj edhe sillet si pushtet nën pushtim kurse unë jam individ që nuk mendon për pushtet, por për çlirimin e shqiptarëve të paçliruar.

LDK-ja ka krijuar Këshill Bashkërenditës me partitë e tjera shqiptare të Kosovës, që nuk i bashkon ato në lëvizje kombëtare sepse është këshill që s’ merr vendime obliguese për të gjitha ato parti, kurse unë mendoj se ne është dashur të ruajmë organizimin në politikë si bërthama të jetës së ardhshme demokratike, por të bashkohemi në lëvizje kombëtare çlirimtare, e cila do të ishte e udhëhequr prej Këshillit Kombëtar, që merr vendime obliguese për të përbërësit e lëvizjes - të bashkohemi në lëvizje që do të lëvizte e jo të mbyllemi në zyra, ku krejt politika rrëgjohet në kumtesa, deklarata, konferenca shtypi!

LDK-ja është parti që katër vjet e ka shikuar e heshtur shpërnguljen e rinisë shqiptare në Evropë, kurse unë në vazhdimësi kam kërkuar, më shkrime e me gojë, që kjo rini të mbetet në Kosovë, i vetëdijshëm se shkuarja e rinisë do të thotë shkuarje e fuqisë sonë çlirimtare.

LDK-ja është parti që krejt bashkëpunimin me Shqipërinë e ka zbritur në bashkupunim me një parti - me partinë në pushtet një me një njeri - me Sali Berishën, kurse unë kam menduar se është më mirë që të bashkëpunohet me të gjitha bashkimet politike të Shqipërisë, që të bashkëpunohet me krejt Shqipërinë, ngulimet shqiptare përjashta dhe, si përfundim i kësaj, të krijohet një organ gjithëshqiptar, që do të përcaktonte politikën kombëtare shqiptare përsa i përket zgjidhjes së çështjes shqiptare.

LDK-ja është parti që është ngritur kundër idesë së pajtimit dhe të bashkimit kombëtar, kurse unë me disa intelektualë të tjerë u jemi bashkuar përprjekjeve të filluara në Tiranë, po, mjerisht, të pasuksesshme, për sendërtimin e një ideje të tillë dhe për hartimin e programit kombëtar që për bashkimet politike shqiptare kudo qofshin ato do të ishte platformë e obligueshme politike kombëtare për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare.

LDK-ja është parti që ka bërë politikë të ulur, nënshtruese ndaj Serbisë, politikë fjalësh, kurse unë kam kërkuar të bëhet qëndresë vepruese, me të gjitha trajtat e mosbindjes qytetare - me greva, protesta, demonstrata, me refuzim të plotësimin të obligimeve qytetare ndaj regjimit pushtues serb e të tjera.

LDK-ja është parti që me politikën e saj nënshtruese dhe servile e ka mohuar rolin historik të popullit të vet, kurse unë kam kërkuar që sendërtimin e qëllimit tonë ta mbështesim, në radhë të parë, në veprimet tona, në mundësitë tona, në flijimet tona, por duke u mbështetur, natyrisht, edhe në fuqitë e mëdha apo në ato prej tyre që mund të kenë më shumë mirëkuptim për ne. E di se asnjë popull i vogël nuk mund t'i zgjidhë çështjet e tij të mëdha pa pasur përkrahjen e fuqive të mëdha, se popujt e vegjël domosdoshmërisht janë të varur prej fuqive të mëdha, por mendoj, dhe këtë e kam theksuar gjithnjë, se përkrahja e fuqive të mëdha, në këtë rast në radhë të parë e SHBA-ve dhe e Gjermanisë, është një përpjesëtim me përprjekjet tona, me qëndresën tonë, me flijimet tona. Në qoftë se ne bëjmë aq sa ka bërë derisot LDK-ja me partitë e tjera më të vogla - domethënë një qoftë se ne bëjmë asgjë, as SHBA-të - që tregojnë mirëkuptim për ne, as fuqitë e tjera të mëdha, nuk mund të bëjnë më shumë se ç'kanë bërë për ne dhe nuk mund të na dhurojnë më shumë se asgjë - fjalë në të cilat shumëshumë na "njihet" një autonomi!

LDK-ja është parti që bën propagandë të gënjeshtërt në lidhje me veprimtarinë e saj dhe në lidhje me politikën e qeverisë së Shqipërisë, në njërën anë, dhe në lidhje me qëndrimet e faktorëve ndërkombëtarë ndaj çështjes shqiptare, në anën tjetër, kurse unë vazhdimisht kam theksuar se ne s'mund të ecim përpara më me tipin e propagandes së gënjeshtërt komuniste, se ne duhet t'ia themi popullit të gjitha: të mirat kur kemi të mira dhe të këqijat ku përjetojmë të këqija!

LDK-ja, me në fund, është parti e cila, pothuaj, ia ka çuar poshtë popullit shqiptar të Kosovës pesë vjet, që, tani, dikush, po i quan *vite të humbura* e dikush *vite të padenja*. Gjendja jonë e sotme e katandisur në Kosovë dhe pozicioni i ulur i çështjes së Kosovës në politikën ndërkombëtare tregojnë se LDK-ja ka bërë politikën që, siç po shihet, i ka shkuar përshtati Serbisë! LDK-ja, sipas mendimit tim, i ka ngarkuar vetes përgjegjësi të madhe kombëtare e morale dhe, doemos, do të japë llogari para brezave të ardhshëm për të gjitha ato që i ka bërë

si nuk duhet, për të gjitha ato që nuk i ka berë, dhe për të gjitha ato që i ka penguar të tjerët që t'i bëjnë. Shkurt: me politikën e saj të ndenjtur, por të sugjeruar dhe me daulle propagandistike të përkrahur prej koka-kola politikës “kombëtare” të pushtetmbajtësve të përtashëm në Tiranë, LDK-ja e ka lënë të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetëvendosje kombëtare pa fuqinë morale që kësaj të drejte ia krijon flijimi. Dhe, kështu, me këtë politikë, që kërkon mëshirë në të katër anët, jo vetëm se është cenuar dinjiteti ynë historik, por është cenuar edhe e drejta jonë e ligjshme për të vendosur vetë, në mënyrë sovrane, për fatin tone historik. Po shpresoj se politika e derisotme e LDK-së nuk është shprehje e vullnetit të numrit më të madh të anëtarëve të kësaj partie; ajo është politikë e udhëheqjes së saj! Vlimet që ngjajnë sot brenda kësaj partie bëjnë të mendohet se ajo do ta kalojë mjerimin në të cilin i ka humbur vitet e shkuara.

Jo ndarje e Kosovës po lëkundje kufijsh

[Robert Elsie]: Shumë shqiptarë, veçanërisht ata në Kosovë, janë të bindur se ribashkimi i Kosovës me Shqipërinë do të realizohet dikur. Disa bëjnë thirrje në mënyrë të hapur për krijimin e një Shqipërie të Madhe. Ju vetë përdorni konceptin “Shqipëria etnike” dhe “kufijtë etnikë”. Çfarë nënkuptoni me të dhe konkretisht ku do të ishin këta kufij?

[Rexhep Qosja]: Nocionin Shqipëri e Madhe e kanë krijuar përfaqësuesit e ideologjisë politike serbomadhe, të cilët në konceptin e tyre të Serbisë së Madhe i kanë parë e, pastaj, edhe i kanë pushtuar Kosovën, në të cilën shqiptarët gjithmonë kanë qenë shumicë e madhe etnike dhe Maqedoninë në të cilën, pothuaj, nuk ka pasur serbë deri pas luftërave ballkanike. Shqipëria, brënda kufijve të së cilës do të ishte Kosova, që e banon një popullatë me rreth 90 për qind shqiptarë, nuk mund të quhet Shqipëri e Madhe, por vetëm Shqipëri natyrore, Shqipëri e vërtetë. Shqipëri etnike quhet shteti kombëtar i shqiptarëve, që do të përbëhej prej Shqipërisë së sotme dhe të gjitha trojeve etnike dhe historike shqiptare, që kanë vazhdimësi gjeografike me Shqipërinë e sotme dhe në të cilat shqiptarët janë popullatë e vetme a shumicë e madhe. Shqipëri etnike quhet Shqipëria Perëndimore (shteti i sotëm shqiptar) dhe Shqipëria Lindore (trojet e paçliruara shqiptare).

[Robert Elsie]: A mendoni se mund të uleni në një tavolinë bashkë me intelektualët serbë dhe të bini dakord mbi ndarjen etnike të rajonit? Nëse jo, atëherë “Shqipëria etnike” e juaj, mos është vetëm një ëndërr?

[Rexhep Qosja]: Ka intelektualë serbë që mendojnë, dhe thonë, se Serbia nuk duhet, sepse nuk ka të drejtë, t'i mbajë shqiptarët me dhunë në përbërje të saj. Jam thellësisht i bindur se sikur gjatë 4-5 vjetëve të fundit të kishim bërë një qëndresë vepruese në Kosovë, sikur jo vetëm me konferencat e shtypit të LDK-së dhe të partive të tjera, por me të gjitha trajtat e mosbindjes qytetare ta kishim treguar vendosmërinë tonë për sendërtimin e të drejtës sonë të ligjshme për vetëvendosje kombëtare, ky numër i intelektualëve serbe do të ishte rritur shumë. Po, si pasojë e politikës që ka ndjekur udhëheqja e LDK-së ky numër i intelektualëve serbë sot është pakësuar shumë.

Është e padrejtë të flitet për ndarje të Kosovës apo, si thoni Ju, të rajonit. Është e drejtë të flitet për ndërrim të kufijve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë (Serbia e Mali i Zi). Shqiptarëve në Kosovë, fjala vjen, iu takon aq territor sa është përqindja e tyre në të e serbëve aq sa është

përçindja e tyre. Kështu mund të thuhet edhe për shqiptarët e serbët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Jugosllavia (Serbia dhe Mali i Zi) nuk do të mund t'i mbajë shqiptarët me dhunë në përbërje të saj. Do të lodhet, do të lodhet prej vendosmërisë sonë që të jemi të lirë e të pavarur, që të jetojmë si popull i bashkuar me vëllezërit tanë në Shqipëri; do të lodhet prej lindshmërisë sonë; do të lodhet prej dhunës së vetvetes. Historia punon për ne; historia punon kundër pushtimit serb në Kosovë.

[Robert Elsie]: Idealja dhe realiteti politik janë ndryshe, veçanërisht në Ballkan. Shumica e popullit në Kosovë përkrah ekzistencën e Republikës së Kosovës, të qeverisë dhe të kushtetutës së saj, megjithëse asnjë vend i botës, bile as Republika e Shqipërisë, nuk e ka njohur Kosovën zyrtarisht. Si realitet gjeopolitik, Kosova është vetëm një pjesë e Serbisë së Madhe. A e njihni ju Republikën e Kosovës siç është sot, dhe a mendoni se kjo republikë mund të bëhet një realitet politik ndonjë ditë, si gjithë vendet e tjera?

[Rexhep Qosja]: Të njohish një shtet domethënë të njohish sovranitetin e tij - lirinë dhe pavarësinë e tij, garanci e të cilit është pushtet me të gjithë përbërësit e tij - administrativë, politikë, policorë, ushtarakë, diplomatikë, monëtarë, ekonomikë. Si mund ta njoh unë një “pushtet kombëtar që emërtohet pushtet nën pushtimin serb? Çfarë garancie i siguron ai sovranitet të Kosovës? Kurrfarë! Si mund ta njoh unë një kryetar, një deputet, një ministër, që nëpër Kosovë lëvizin me letërnjoftimet serbe, që kufirin e Kosovës e kalojnë me pasaportat serbe, që obligimet qytetare i kryejnë para pushteteve serbe? Si mund ta njoh unë një kryetar a deputet që çdo polic serb mund t'i kapë për veshi dhe t'i çojë ku të dojë kur të dojë! Jo. Ky nuk është pushtet sovran që njihet dhe nderohet! Ky është një teatër tragjikomik pushtetor, i krijuar me qëllim që të shmanget qëndresa vepruese. Ky pseudopushtet, që toleron Serbia, ky pseudopushtet që, natyrisht padashje është shndërruar në rojtar të shpinës së Serbisë ajo derisa është e zënë në luftë në Bosnjë dhe në Kroaci, ka kontribuar që të jemi këtu ku jemi: në katandisjen më të rëndë politike, sociale dhe morale që kemi përjetuar gjatë 83 viteve të fundit! Dhe, ky pseudopushtet deri sot u ka shërbyer vetëm interesave të atyre që mendojnë se e ushtrojnë. Dhe, ky pseudopushtet deri sot e ka dëshpëruar fort çdo shqiptar që mendon me kokë të vet. Populli shqiptar i Kosovës nuk e ka merituar në poshtërim të tillë.

Më parë se në zgjidhjen e çështjes shqiptare përmes krijimit të shtetit të dytë shqiptar në Ballkan, me ç'ka nuk do të pajtohej asnjë shtet ballkanik fqinjë i shqiptarëve, besoj në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, prandaj edhe të çështjes shqiptare, përmes bashkimit të shqiptarëve e kjo domethënë të tokave, në të cilat ata janë popullatë e vetme dhe shumicë etnike, që kanë vazhdimësi gjeografike me Shqipërinë, në një shtet - në Shqipërinë e bashkuar.

Qeveria shqiptare dhe Kosova sot

[Robert Elsie]: Keni bërë polemikë me udhëheqësit e Republikës së Shqipërisë, dhe thonë se nuk jeni pritur mirë në Tiranë. Ku është thelbi i pakënaqësisë suaj me politikanët e Tiranës nëse ekziston? Qeveria shqiptare, çfarë bën mirë dhe çfarë bën keq lidhur me çështjen e Kosovës?

[Rexhep Qosja]: Do të mund të thuhet se nuk jam pritur mirë në Tiranë vetëm në qoftë se njëjtësohet regjimi me popullin, me shoqërinë, me shtetin, në qoftë se, madje, disa

funksionarë të atij regjimi njëjtësohen me popullin, me shoqërinë dhe me shtetin. Regjimi shqiptar nuk është populli shqiptar; regjimi shqiptar nuk është Shqipëria. E kritikoj regjimin sepse e dua Shqipërinë. Meqenëse në botën shqiptare vazhdon populli të jetë një e regjimi diçka tjetër - sepse regjimet shqiptare ende nuk janë demokratike, nuk mund të thuhet se nuk jam pritur mirë në Tiranë meqë më ka trajtuar keq regjimi. Njerëzit e thjeshtë, intelektualët më kanë pritur mirë dhe, të jeni shumë të bindur, më mirë se asnjë shqiptar tjetër nga trojet shqiptare në ish-Jugosllavi. Nuk më kanë pritur mirë disa funksionarë, të cilët, ç'është e vërteta, as nuk kam dëshiruar të më presin mirë. Nuk kam qenë dhe nuk do të jem intelektual i regjimeve.

Më pyetni se çfarë bën mirë Qeveria e Tiranës lidhur me çështjen e Kosovës.

Diplomacia shqiptare larg më shumë se përpara merret me çështjen e Kosovës. Ambasadat shqiptare bëjnë përpjekje t'i sigurojnë takimet e veprimtarëve politikë shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia me përfaqësues të qeverive të ndryshme në botë dhe me përfaqësues të institucioneve a forumeve ndërkombëtare. Dhe, kjo është e mire.

Më pyetni se çfarë bën keq Qeveria e Tiranës lidhur me çështjen e Kosovës.

Qeveria shqiptare ende nuk ka koncept të trajtësuar dhe të qëndruar për çështjen shqiptare; përpara i ndërronte gati çdo javë, kurse tani i ndërron gati çdo muaj konceptet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Qeveria shqiptare e ka rrëgjuar bashkëpunimin politik me forcat politike të Kosovës në bashkëpunim me një parti dhe me dy tre vetë të kësaj partie! Dhe kështu e ka ndarë e copëtuar lëvizjen tonë; dhe kështu, duke e rrëgjuar bashkëpunimin me shqiptarët e Kosovës në bashkëpunim me disa veta të dëgjueshëm, e ka privuar lëvizjen tonë nga fuqia morale që sjell bashkimi dhe, kështu e ka dobësuar lëvizjen tonë; dhe, kështu i ka thjeshtësuar aftësitë tona politike dhe të tjera.

Qeveria shqiptare mban marrëdhënie politike dhe ekonomike me Malin e Zi, pas të cilave në të vërtetë fshihen marrëdhënie me Serbinë dhe këto marrëdhënie nuk mund të mos shprehen frenueshëm në mundësinë e zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës.

Qeveria shqiptare prej se është vënë rrethimi ekonomik i Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) e thyen këtë rrethim në Mal të Zi dhe e furnizon Serbinë me naftën shqiptare a me naftë përmes Shqipërisë. Dhe, nuk është më fshehtësi, se për këtë është arritur marrëveshja mes Sali Berishës dhe kryetarit të Malit të Zi, Bullatoviqit, me rastin e vizitës së këtij të fundit në Tiranë para tre vjetësh. Në qoftë se populli shqiptar është një - e është një, në qoftë se në emrin e gjysmës së popullit shqiptar që jeton në Shqipëri nuk mund të bëhet politikë pa u mbajtur parasysh edhe interesat e gjysmës tjetër që jeton në anen tjetër të kufirit, ashtu siç as kjo gjysma e këndej kufirit nuk mund të bëjë politikë pa pasur parasysh interesat e gjysmës tjetër që jeton në Shqipëri, atëherë del se regjimi i Sali Berishës, duke ia shitur naftën Serbisë dhe Malit të Zi, e ndihmon e vazhdimin e pushtimit serb të Kosovës. Historia, jam thellë i bindur, do ta vërë në bankë të zezë për këtë. E, mund të jetë, jo vetëm historia.

[Robert Elsie]: Çfarë pret populli i Kosovës nga Shqipëria? A e ndien veten të përkrahur nga Shqipëria apo të tradhëtuar?

[Rexhep Qosja]: Populli shqiptar i Kosovës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë i tradhëtuar nga Shqipëria. Jo. Plaga e Kosovës në trupin e Shqipërisë është plagë e madhe, e hapur, që dhemb pa ndërprerje. Në qëndrimin ndaj Kosovës, ndaj fatit të saj, prej luftërave ballkanike provohet atdhetarizmi shqiptar dhe këtë atdhetarizëm populli shqiptar në Shqipëri e ka dëshmuar në mënyrën më shembullore, në vazhdimësi. Kjo nuk mund të thuhet për regjimet e Shqipërisë me përjashtim të atij të Ismail Qemalit e të Fan Nolit; kjo nuk mund të thuhet, sidomos, për kryepushtetarët e regjimit të sotëm, të cilët në mënyrë përlulëse shikojnë se si t'u përshtaten atyre konjunkturave ndërkombëtare, që u premtojnë sundim të gjatë vetëm e vetëm që të mos kërkojnë më shumë se ç'kërkojnë - modus vivendi, hapësirë demokratike, të drejta njerëzore a autonomi për Kosovën!

[Robert Elsie]: Me siguri keni dëgjuar se ekziston një qëndrim i theksuar kundër kosovarëve në popullatën e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në Tiranë dhe në jug. Si e shpjegoni këtë?

[Rexhep Qosja]: Mund të ketë disponim kundërkosovar te disa veta, te disa grupe interesash, apo te disa grupe politike, por në asnjë mënyrë nuk mund të ketë disponim kundërkosovar te populli i Shqipërisë. Ndonjë mendjeshkurtër i tutet bashkimit të shqiptarëve sepse i tutet konkurrencës punuese! Ndonjë mendjeshkurtër i tutet bashkimit të shqiptarëve sepse i tutet konkurrencës pushtetore! Por këta dikusha e në të vërtetë askusha janë pak, tepër pak, në të dy anët e kufirit. Disponimi kundër Kosovës në Shqipëri apo disponimi kundër Shqipërisë në Kosovë është një prej atyre marrive djallëzore, që e trumbetojnë "atdhetarët" e kafeneve që Atdheun e njëjtësojnë me fshatin, qytezën a krahinën e tyre.

Për popullin disponimi i tillë, në thelb kundërkombëtar, është kundërnaturor, sepse te populli është pambarimisht e madhe dëshira e përbashkësisë, ndjenja e përbashkësisë. Domethënë: rastet e veçanta s'duhet t'i shpallim dukuri të përgjithshme.

Shtresa intelektuale në një vend në zhvillim siç është Shqipëria, ka një rëndësi të veçantë, mirëpo duket tani për tani se shumë intelektualë, si në Kosovë edhe në Shqipëri, nuk marrin pjesë në jetën politike të vendit. Pse?

[Rexhep Qosja]: Intelektualët shqiptarë kanë përvojë tepër të hidhur politike. Kane qenë me dhunë të detyruar t'u afrohen regjimeve - natyrisht jo të gjithë të detyruar, kanë qenë të shtypur, të ndjekur, të nëpërkëmbur prej politikës. Për këto arsye, shumë prej tyre tani nuk e duan politikën. Është edhe një arsye tjetër që intelektualët shqiptarë i bën sot të mos e duan politikën: është figura e politikanit ballkanik - njeri i pabesë, dyfyturësh, servil para të huajve, mashtrues, gjysmak, despot para të vetëve, në fund i urrejtur në popull.

Si të rindërtohet ajo që është shpërbërë

[Robert Elsie]: Në çfarë mase komuniteti ndërkombëtar, bie fjala Unioni Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, e kupton situatën në Kosovë? A jeni i kënaqur apo i zhgënjyer nga qëndrimi i botës së jashtme?

[Rexhep Qosja]: Bashkësia ndërkombëtare, Unioni Evropian dhe SHBA-të, ende mendojnë ose, ndoshta, ashtu vetëm thonë se me sigurimin e të drejtave njerëzore dhe të një autonomie

brenda Serbisë mund të zgjidhet çështja e Kosovës. Kjo tregon se ata nuk e shohin drejt, se e kuptojnë sipërfaqshëm, situatën në Kosovë. Po ta shihnin në thelb gjendjen tonë do ta dinin se rendi, drejtësia e paqjes në Kosovë nuk mund te vendosen pa u bashkuar Kosova me Shqipërinë sepse kjo është dëshira e mbi 90 për qind të popullatës së Kosovës. Sjellja e faktorëve ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës është zhgënjyese sado që historia na ka mësuar se shumë prej tyre ne s'mund të presim. Po sot është zhgënjyese edhe sjellja jonë ndaj vetvetes!

[Robert Elsie]: Ju lindët dhe u rritët në Kosovë, në një krahinë të përzier etnikisht, me shqiptarë dhe serbë. Kur ishit i ri, a kishit ju miq të ngushtë serbë? Dhe a keni tani miq serbë? Në rast se jo, atëherë pse? Çfarë të ardhme parashikoni për pakicën serbe brenda kufijve të Shqipërisë etnike?

[Rexhep Qosja]: Kam lindur në një krahinë, në Krahinën e Plavës e Gucisë, që pas luftërave ballkanike ka mbetur nën pushtimin e Malit të Zi e, pastaj, të Jugosllavisë. Përpara, në kohën e Turqisë, kjo krahinë i ka takuar Vilajetit të Kosovës. Në vendlindjen time ka pasur vetëm një familje malazeze e sjellë si koloniste dhe ajo ka pasur një djalë një vjet me të ri se unë. S'kemi pasur të këqija mes vete, por nuk kemi pasur as kurrfarë miqësie. Ishim dy botëra të ndryshme. Në Prishtinë jam rritur, jam shkolluar, kam krijuar familje, kam krijuar veprën dhe këtu, kur të vdes, do të varrosem. Me intelektualë serbë, kryesisht shkrimtarë, deri vonë kemi qenë në një shoqatë - në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës, me intelektualë serbë deri vonë kemi punuar edhe në Universitet. Kam pasur komunikim korrekt me ta. Sot nuk kam kurrfarë komunikimi me ta.

Pakicës serbe në Shqipërinë etnike do të kërkoja t'i pranohen të gjitha të drejtat - njerëzore, politike, qytetare, madje, edhe e drejta e vetëvendosjes. Çuditë, prandaj, pse edhe ata ne nuk na i pranojnë këto të drejta.

[Robert Elsie]: Po të kishit mundësinë të vendosnit vetë për fatin e Kosovës, çfarë zgjidhjeje, çfarë statusi do të vendosnit ju?

[Rexhep Qosja]: Do ta bashkoja me Shqipërinë. Si demokrat, do të organizoja referendum në hapësirën e bashkuar etnike shqiptare dhe, jam i bindur, se populli shqiptar me 99,99 % do të deklarohej për bashkim. Mandej do të organizoja zgjedhjet për Kuvendin ligjvënës dhe, pas nxjerrjes së Kushtetutës, do të mbaheshin zgjedhjet për kryetar në të cilat do të zgjedhej Kryetari i Shqipërisë, i cili, natyrisht, do të quhej Kryetar e jo president.

[Robert Elsie]: Pavarësisht nga dëshirat dhe nga shpresat tuaja për të ardhmen e Kosovës, si e parashikoni vazhdimësinë e situatës politike reale në Kosovë për vitet që do të vijnë?

[Rexhep Qosja]: Në librin tim *Strategjia e Bashkimit Shqiptar*, të botuar në vitin 1992, kam shkruar se zgjidhja e çështjes shqiptare është një proces që do të zgjasë. Politika jonë johistorike e 4-5 vjetëve të fundit këtë zgjidhje e ka zgjatur edhe më. Është mallkim i yni historik vonimi në çastet vendimtare. Dhe, si pasojë e kësaj politike ne jemi vonuar. Do të duhen shumë mundime që, tani, të përplotësohet ajo që është humbur. Do të jetë shumë e vështirë që të rindërtohet ajo që në lëvizjen tonë kombëtare është shpërbërë si pasojë e politikës shkurtpamëse të regjimit të përtashëm në Tiranë dhe si pasojë e politikës sektariste të LDK-së në Kosovë. Do të jetë e vështirë, por jo e pamundshme. Jeta e shqiptarëve në

Kosovë do të vazhdojë të jetë e rëndë; terrori serb do të ketë batica e zbatica, por do të jete i pandalshëm. Mund të ketë tendosje të ashpra mes shqiptarëve dhe serbëve e malazezve. Një është, ndërkaq, e sigurt: doemos do të vijë dita kur Kosova do të shkëputet prej Serbisë dhe do të bashkohet me Shqipërinë. Kur e them këtë e kam parasysh përvojën historike që dëshmon se: kur një popull është i vendosur në përpjekjet e tij që të çlirohet dhe të bëhet i pavarur, doemos do të çlirohet dhe do të bëhet i pavarur. Dëshirën çlirimtare të një populli nuk mund ta mposht dhuna e pushtuesit, dhe nuk mund ta dëshpërojë mjerimi politik dhe moral i klasës së tij politike.

[Intervistë e zhvilluar më 16.05.1995. Botuar shqip në: Rexhep Qosja, *Ligjërime Paravajtëse*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1996, f. 437_448. Botuar anglisht në: Robert Elsie, *Kosovo: in the Heart of the Powder Keg*, East European Monographs, CDLXXVIII, ISBN 0-88033-375-8, Boulder, Distributed by Columbia University Press, New York 1997, f. 494-505.]